



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1329 Prot.

Korçë, më 26.07.2019

VENDIM

Nr. 407, datë 26.07.2019

PËR

MOSMIRATIMIN E PROPOZIMIT TË SENATIT AKADEMIK PËR
MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE QË NDJEKIN STUDIMET
NË VITIN I, TË CIKLIT I, NË FAKULTETIN E BUJQËSISË

Bordi i Administrimit i mbledhur në datën 26.07.2019 mori në shqyrtim Vendimin nr. 405 datë 24.07.2019 (nr.1316 prot.), të Senatit Akademik, shoqëruar edhe me shkresën nr.1314 prot., datë 24.07.2019, të Fakultetit të Bujqësisë, "Ridërgim i kërkesës për mbështetje financiare për studentët që do të ndjekin studimet në vitin e I, Cikli I, në Fakultetin e Bujqësisë". Pasi diskutoi në lidhje me këtë çështje, Bordi i Administrimit,

KONSTATOI SE:

1. Me shkresën nr 1253/1 prot., datë 17.07.2019, "Kthim përgjigjeje për shkresën nr.1253 prot., datë 15.07.2019", drejtuar Bordit të Administrimit, Sektori Juridik nuk ka dhënë një interpretim apo argumentim që të ndihmojë Bordin në qëndrimin që do mbajë në lidhje me këtë çështje, si dhe për t'u qartësuar përsa i përket ligjshmërisë së kërkesës së Fakultetit të Bujqësisë dhe të vendimit nr. 405 datë 24.07.2019 (nr.1316 prot.), të Senatit Akademik.

Autonomia financiare e Universitetit që përmendet si argument në përgjigjen e Sektorit Juridik, si edhe në vendimin nr. 405 datë 24.07.2019 (nr.1316 prot.), të Senatit Akademik nuk është një argument i ri dhe i panjohur për Bordin, madje ajo është baza e kërkesave për "*mbështetjen financiare*" në fjalë, por autonomia financiare zhvillohet brenda kuadrit ligjor në fuqi për arsimin, financat dhe më gjerë që lidhen direkt ose indirekt me veprimtarinë e universitetit.

Më konkretisht, lidhur me çështjen në fjalë, në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në

Republikën e Shqipërisë», neni 112 «Granti i mësimdhënies», pika 5, përcaktohet se:

“5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Gjithashtu në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, pika 3, përcaktohet se:

“3. Bursat e studimit për studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallura të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, u shpërndahen studentëve që studiojnë në këto programe dhe institucione, sipas masës së përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët që frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”

Përsa përcaktohet në dispozitat e cituara më sipër, **programet e studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, përcaktohen si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave** dhe për këtë çështje ende nuk ka dalë një vendim i Këshillit të Ministrave, në bazë të të cilit, të mund të veprohet nga ana e Universitetit, nëpërmjet vendimmarrjes së Bordit të Administrimit, si organi më i lartë kolegjal administrativ i tij.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, ku është bazuar kërkesa e Fakultetit të Bujqësisë, dhe propozimi i SA (referuar http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf, faqja 13, ku përcaktohen 6 përparësitë e qeverisjes, faqja 44, ku përcaktohen prioritetet e zhvillimit), nuk përcakton programet e studimit me prioritet kombëtar dhe as Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit “Fan.S. Noli” Korçë 2016-2020, Seksioni Fusha Strategjike, Edukimi – Kërkimi, Objektivi A.B.1.11, që i referohet treguesit T.01. Stimulimi i studentëve cilësorë., T.06. Stimulimi i studentëve me prirje të veçanta, Analiza SWOT, seksioni Mundësitë (Mundësia e dhënies së shpërblimeve financiare nga organizma qeveritare për studentët me rezultate më të mira në fakultete), nuk justifikojnë dhënien e kësaj mbështetje financiare, pasi vetë Fakulteti i Bujqësisë pohon se niveli i studentëve është shumë i dobët.

2. Pretendimi për rënien e numrit të studentëve nuk qëndron, pasi treguesit e paraqitur nga Fakulteti i Bujqësisë tregojnë rritjen të këtij numri nga 38 studentë në vitin

akademik 2017-2018, në 56 studentë për vitin akademik 2018-2019, pra një rritje prej 47%.

3. Për sa i takon llogaritjes së efektit financiar ka mungesë koherence që shprehet nga dy parashikime të ndryshme financiare, e para, vlera 2 700 000 lek në vit në shkresën nr. 2021 prot., datë 23.10.2018, të Fakultetit të Bujqësisë, dhe e dyta vlera 3 600 000 lek në vit, për 4 deri 5 vjet në total, përkatësisht 14 400 000 deri 18 000 000 lekë, në shkresën nr. 1314 prot., datë 24.07.2019 të po këtij fakulteti. Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2018, të ardhurat e siguruara nga tarifrat, regjistrimi dhe shkollimi janë në shifrën 100 000 000 lekë. Mbështetja financiare prej 3 600 000 milionë lekë për studentët e Fakultetit të Bujqësisë, për më tepër studentë me rezultate të dobëta, përbën rreth 3.6 %, të fondit që sigurohet kryesisht nga të ardhurat e studentëve, mes të cilëve edhe shumë studentë me rezultate të mira dhe shumë të mira. Kjo mbështetje, me siguri që do të shkaktonte pakënaqësi tek studentët cilësorë, të cilët nuk përfitojnë bursa apo mbështetje financiare.

Përsa më sipër, Bordi i Administrimit e ka të pamundur të pranojë kërkesën e Fakultetit të Bujqësisë dhe propozimin e Senatit Akademik për mbështetjen financiare të studentëve që ndjekin studimet në Vitin e I, të Ciklit I, në Fakultetin e Bujqësisë.

Në përfundim, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», nenet 47 dhe 112, pika 5, si dhe referuar sa u relatua më sipër, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë propozimin e Senatit Akademik me Vendimin nr. 405, datë 24.07.2019 (nr.1316 prot.) të tij, për mbështetjen financiare të studentëve që ndjekin studimet në Vitin e I, të Ciklit I, në Fakultetin e Bujqësisë, përcjellë Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof.as.dr Mamica Nene

